DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
-III- Nr. Br. No. 0204-734/1
Data Datum Date 19.06.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 10.06.2013
Nr. 0204-734

**PËR:** Blerim Kuqi, Kryetar i Komunës së Suharekës
Vesel Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SUHAREKËS, 01 Nr. 16 - 4055, Pranuar me datë, 07.06.2013**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 16 - 4055 të miratuar me datë 31.05.2013, ***KONFIRMON*** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 16 - 4055, për inicimin e procedurave për hartimin e planit zhvillimor urban për nën qendrën Mushtisht.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Minister i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALBJE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
-III- Nr. Br. No. 0204-734/1
Data Datum Date 19.06.2013

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

---

Datum: 10.06.2013
br. 0204-734

**Za:** Blerim Kuqi, Gradonačelnik opštine Suva Reka
Vesel Maliqaj, Predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka

**Predmet:Potvrda zakonitosti odluke opštine Suva Reka, 01 br. 16 - 4055**, primljeno dana , **07.06.2013**

Poštovanj/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim adminstativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br. 16 - 4055 odobreno dana 31.05.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01 br. 16 - 4055, o pokretanju procedura o izradi urbanističkog razvojnog plana u centru Mushtisht.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*
*Arhivi MALS-a.*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, konform nenit 16, të Ligjit, Nr-2003/14, për planifikim hapësinor, dhe dispozitave të udhëzimit administrativ, 02/05, për implementimin e Ligjit për planifikimin hapësinorë, dispozitave kalimtare të PZHK-së, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 31.05.2013, mori këtë:

# VENDIM
# PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR URBAN PËR NËN QENDRËN MUSHTISHT

## Neni 1.

Me këtë vendim lejohet inicimi i procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Urban për nën qendrën, Mushtisht, me vendbanimet Mushtisht, Dvoran, Maqitevë dhe Dolloc sipas kufijve të specifikuar me Plan Zhvillimor Komunal.

## Neni 2.

Bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Urban për nën qendrën Mushtitsht, do të jetë Plani Zhvillimor Komunal, planet aktuale detale si dhe gjendja ekzistuese në teren.

## Neni 3.

Përcjellëse e procesit të hartimit të planit është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës në Suharekë.

## Neni 4.

Bartës për procesin e hartimit të planit është firma kontraktuese e përzgjedhur përmes procedurave të rregullta tenderuese.

## Neni 5.

Barrësi i hartimit të planit sipas nenit 4, të këtij vendimi është i obliguar që planin ta hartoj në afat prej 6, muajve nga dita e lidhjes së kontratës për hartimin e tij si dhe dokumentin final ta emërtojë, përpilojë dhe kompletojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në kohën e sjelljes së dokumentit për miratim në Kuvendin e Komunës në Suharekë.

## Neni 6.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013 për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS– SUHAREKË

01-Nr-16-4055
Më datë 31.05.2013

Kryesuesi i Kuvendit
Vasel Maliqaj

OK